



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.927/13 prot.

Tiranë, më 30.08.2023

VENDIM

Nr. 37, datë 30.08.2023

PËR KONTROLLUESIN “EXPRESS PRINT SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Express Print shpk” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 77, datë 29.05.2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Express Print shpk”, me objekt:

- Verifikimi i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03. 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Pranë Zyrës së Komisionerit janë paraqitur disa ankesa, përmes të cilave ankuesit/subjektet e të dhënave personale, pretendojnë se në mënyrë të vazhdueshme, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, kanë marrë telefonata hyrëse dhe mesazhe në telefoninë e lëvizshme për qëllime politike, në kundërshtim me parimet dhe kriteret e mbrojtjes së të dhënave personale, të përcaktuara në legjislacionin kombëtar të fushës.

Subjektet e të dhënave personale pretendojnë se në numrat celular personal, ju kanë mbërritur mesazhe promocionale në kuadër të fushatës zgjedhore, në emër të përfaqësuesit të koalicionit “*Bashkë Fitojmë*”. Mesazhet elektronike janë gjeneruar nga 11 numra celular të ndryshëm të konstatuar, sipas procesverbalit të hetimit administrativ.

Me qëllim hetimin e mëtejshëm të këtij rasti, me shkresën nr. 927/1 prot., datë 16.05.2023, Zyra e Komisionerit fillimisht i është drejtuar Vodafone Albania sh.a, për identifikimin e zotëruesve të numrave të sipërpërmendur. Me shkresën nr. ref. FRS/1275/IB datë 18.05.2023, Vodafone Albania sh.a., bën me dije se numrat janë në zotërim të pajtimtarit “Express Print” shpk, me administrator z. G. M.

“Express Print” shpk. është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L32307064V dhe ushtron veprimtarinë duke ofruar shtypshkrime, botime dhe printime të materialeve të ndryshme, krijim dhe realizim të shërbimeve në fushën e web-design, design, realizimin e shërbimeve të marketingut dhe konsulencës në këtë fushë, tregtim të produkteve dhe shërbimeve, drejtpërdrejtë tek klientët ose online në internet (e-commerce).

2. Në zbatim të Urdhrit nr. 77, datë 29.05.2023 të Komisionerit, është iniciuar hetim administrativ ndaj kontrolluesit “Express Print” shpk. Përgjatë hetimit, është konstatuar se ky subjekt disponon një “Kontratë Shërbimi” të lidhur më datë 15.04.2023, me përfituesin e shërbimit z. B. K, kandidat për Kryetar të Bashkisë Tiranë. Në këtë kontratë në pikën 3, 6 dhe 7 të nenit 1 “Objekti i Kontratës”, parashikohet se shërbimet që ofruesi i shërbimit (në këtë rast “Express Print” shpk) do të ofrojë për përfituesin e shërbimit (z. B.K), bazuar në kërkesën e tij, konsistojnë në:

“3. Ofrim i shërbimit të marketingut për fushatën zgjedhore;

6. Komunikim me zgjedhës direkt dhe indirekt nëpërmjet mënyrave të komunikimit në rrjete sociale me mesazhe digjitale, telefonata ose rrjete të tjera komunikimi;

7. Dërgim i mesazheve digjitale, nëpërmjet sistemeve dhe mundësive që ofruesi i shërbimit ka në destinacionet e kërkuara nga përfituesi i shërbimit ose koalicioni “Bashkë Fitojmë” sipas të dhënave dhe listave që koalicioni disponon.”

Ndërsa, në pikën 4, të nenit 4 të kësaj kontrate parashikohen të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të shërbimit, konkretisht: *“4. Përfituesi i shërbimit merr përsipër të vendosë në dispozicion të ofruesit të shërbimit një grup vullnetarësh që ndihmojnë në realizimin e fushatës zgjedhore për përfituesin e shërbimit, sipas detyrave që do të caktojnë bashkërisht ofruesi i shërbimit me përfituesin e shërbimit për ta”.*

Përfaqësuesi i kontrolluesit, z. G.M ka deklaruar se: *“Në përmbushje të Akt-Marrëveshjes datë 20.04.2023 midis palëve Shoqëria “Express Print sh.pk” dhe Koalicionit “Bashkë Fitojmë”,(z. B. K. përfaqësues i subjektit politik), palës përfituese të shërbimit i është vendosur në dispozicion lista e kartave SIM, e cila është përgjegjëse për caktimin e personelit që i përdor si dhe komunikimet elektronike për qëllimin e-commerce.”* Pra, këto numra “Express Print shpk” i ka vendosur në

dispozicion të përfaqësuesit të subjektit politik, nëpërmjet kontratës së mësipërme dhe marrëveshjes përkatëse.

3. Me shkresën nr. 927/4 prot., datë 04.07.2023, Zyra e Komisionerit ka kërkuar një interpretim ligjor të rastit nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (në vijim, "AKEP"), nëse lejohet nga legjislacioni specifik, rregullimi i marrëdhënieve midis pajtimtarit të numrit/numrave me palë të treta, në rastin konkret, dhënia në përdorim e numrave celularë nga shoqëria "Express Print shpk" drejt kandidatit të koalicionit "Bashkë Fitojmë", z. B. K. (përfitues i shërbimit), duke përdorur një kontratë shërbimi, për qëllime marketingu për fushatën zgjedhore.

Nëpërmjet shkresës nr. 1792/1 prot., datë 21.07.2023, AKEP ka kthyer përgjigje, ku ndër të tjera, vlerëson se: "Kontrata e pajtimit, lidhur midis sipërmarrësit që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, përbën ligjin specifik të zbatueshëm nga palët" dhe në nenin 690 të Kodit Civil parashikohet se: "Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit". Gjithashtu, AKEP ka referuar edhe nenin 128 "Komunikimet pa kërkesë" të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

4. Më tej, me shkresën nr. 927/5 prot., datë 10.07.2023, Zyra e Komisionerit ka kërkuar pranë shoqërisë telefonike "Vodafone Albania sh.a." (në vijim, "Vodafone") një kopje të kontratës së lidhur me subjektin tregtar "Express Print shpk.", me qëllim evidentimin e përgjegjësiwe/detyrimeve kontraktuale. Nëpërmjet shkresës nr. LEA/031/MLL, datë 24.07.2023, Vodafone ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, një kopje të "Termave dhe Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit të nënshkruar me pajtimtarin "Express Print shpk".

Referuar kontratës, në pikën 3 të saj, parashikohet lidhja me rrjetin dhe dhënia e shërbimeve, konkretisht në germën "e" të kësaj pike citohet: "Të gjitha komunikimet e kryera nëpërmjet kartës SIM do të konsiderohen si të kryera nga vetë pajtimtari apo me pëlqimin/miratimin e tij. Si rrjedhim, pajtimtari do të jetë përgjegjës sipas këtyre Termave dhe legjislacionit në fuqi për përdorimin e kartës së tij SIM." Gjithashtu, në germën "d", të nenit 12 të kësaj kontrate, parashikohen të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit për përdorimin e shërbimeve nëpërmjet pajisjeve fundore të pajtimtarit, ku specifikohet se pajtimtari detyrohet: "d) Të mos ofrojë/rishesë të tretëve për arsye përfitimi kartën SIM ose shërbime të tjera të ofruar nga Vodafone."

Në kushte të tilla, Zyra e Komisionerit vlerëson se "Express Print shpk", rezulton të jetë në shkelje të parashikimeve kontraktuale dhe ligjore. Duke qenë zotëruesi i kartave SIM dhe duke i përdorur ato për të ofruar shërbime të marketingut për fushatën zgjedhore sikurse del qartë nga objekti i "Kontratës së shërbimit të datës 15.04.2023" si dhe provave të paraqitura nga ankuesit, "Express Print shpk" mban përgjegjësi si kontrollues i të dhënave personale, në kuptim të Ligjit.

Me qëllim interpretimin e qartë të pozitës së këtij subjekti, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në kuptim të pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, ka atributet e Kontrolluesit, çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, si dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.”

Sa i takon evidentimit të qartë të cilësisë si “Kontrollues” të “Express Print shpk” rezulton se ky subjekt përmes një kontrate e cila ka forcën e ligjit midis palëve (*kontrata me Vodafone Albania sh.a.*), në funksion të aktivitetit/ veprimtarisë së tij tregtare ka marrë disa numra telefoni. Më tej, ka qenë vetë subjekti “Express Print shpk” i cili përmes një kontrate (*për qëllime përfitimi*) me një palë të tretë, ka përcaktuar se, numrat që ai disponon do të përdoren për qëllim të ofrimit të shërbimit të marketingut në kuadër të fushatës elektorale, duke identifikuar qartazi edhe mënyrën e ofrimit të këtij shërbimi (*përmes dërgimit të mesazheve elektronike ndaj subjekteve të të dhënave personale*).

Cilësia e kontrolluesit bartet nga subjekti kur ai përmbush kushtet kumulative si: *a. përcakton (vetëm apo së bashku me të tjerë), qëllimet dhe mënyrat e përpunimit; dhe b. përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale (parimi i llogaridhënies, i parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale).*

Në rastin konkret evidentohet qartazi që subjekti “Express Print shpk” ka qenë përcaktuesi i veprimeve të kryera përmes numrave të telefonit që ai zotëron si pajtimtar, dhe si i tillë ka përgjegjësinë e plotë të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky detyrim Kontrolluesit i buron nga ligji po ashtu edhe nga kontrata që ka me Vodafone e cila përbën edhe “lex specialis” në këtë rast.

Kontrolluesi nuk mundet që të shkarkojë veten nga përgjegjësia për veprimtarinë e kryer përmes këtyre numrave, duke u mbështetur në argumentin se këto numra i janë ofruar subjektit zgjedhor dhe ky i fundit mban përgjegjësi, pasi vetë “lex specialis” (*kontrata e pajtimit*) ia ka mohuar të drejtën për të ofruar/rishitur të tretëve për arsye përfitimi kartën SIM ose shërbime të tjera të ofruar nga Vodafone, për rrjedhojë të gjitha komunikimet e kryera nëpërmjet kartave SIM konsiderohen si të kryera nga vetë pajtimtari apo me pëlqimin/miratimin e tij-

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime marketingu për fushatën zgjedhore, pavarësisht mënyrës së gjenerimit të të dhënave personale (në këtë rast numrat e telefonit), është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së përpunimit sanksionuar në germën “a” të

pikës 1 të nenit 5 dhe me kriterin ligjor të përpunimit sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

Ekzistenca e pëlqimit në këtë rast është e vetmja mundësi ligjore e Kontrolluesit, referuar pikës 5 të nenit 6 të Ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 e Ligjit, “*duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*”.

Për sa kohë Kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për Njoftim, në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për njoftim të përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, me shkresën nr. 927/11 Prot., datë 28.07.2023, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit nuk u paraqit në seancën dëgjimore, por nëpërmjet email-it të datës 04.08.2023, parashtrroi qëndrimin e tij mbi konstatimet e grupit të hetimit, si më poshtë:

- *Sikundër është parashtruar në këtë dokument, numrat e telefonit të cituar në të, janë në zotërim të subjektit tregtar që unë përfaqësoj dhe konkretisht “Express Print” shpk. Këto numra telefoni zotërohen nga ana ime, mbi bazën e një kontrate të rregullt të nënshkruar midis Vodafone sh.a. dhe subjektit tregtar që përfaqësoj. Në kuadër të veprimtarisë ekonomike, subjekti “Express Print” shpk. dhe z. B. K., si kandidat për Bashkinë e Tiranës, në zgjedhjet për pushtetin vendor të vitit 2023, kanë nënshkruar një kontratë shërbimi në datën 15/04/2023, ku midis të tjerash, shoqëria që përfaqësoj*

do të kryente në favor të këtij të fundit, disa shërbime në lidhje me fushatën zgjedhore që ky kandidat po zhvillonte në qytetin e Tiranës.

Në datë 20.04.2023, palët kontraktuese si më sipër, kanë ndryshuar kontratën e sipërcituar, duke parashikuar se subjekti që përfaqësoj do t'i vendoste në dispozicion subjektit zgjedhor 40 numra telefonikë. I vetmi shërbim që do të kryente subjekti që përfaqësoj, ishte ai i vendosjes në dispozicion të numrave të telefonit dhe asgjë më tepër. Mesazhet, telefonatat, arkivimi, trajtimi apo përpunimi i çdolloj të dhëne personale do të kryhej nga subjekti zgjedhor, duke më shkarkuar nga çdolloj përgjegjësie ligjore.

Sa i takon këtij pretendimi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Vodafone për *“Termat e përgjithshme të kontratës me pajtimtarët”*, konkretisht në nenin 12, parashikohen të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit, ku në germën *“d”* parashikohet se: *“Pajtimtari detyrohet: Të mos ofrojë/rishesë të tretëve për arsye përfitimi kartën SIM ose shërbime të tjera të ofruar nga Vodafone.”*

Gjithashtu, në pikën 3 të kontratës së pajtimit, parashikohet lidhja me rrjetin dhe dhënia e shërbimeve, në germën *“e”* të së cilës, parashikohet se: *“Të gjitha komunikimet e kryera nëpërmjet kartës SIM do të konsiderohen si të kryera nga vetë Pajtimtari apo me pëlqimin miratimin e tij. Si rrjedhim, pajtimtari do të jetë përgjegjës sipas këtyre Termave dhe legjislacionit në fuqi për përdorimin e kartës së tij.”*

Për sa më sipër, veprimet e kryera nga pala e tretë për dërgimin e mesazheve promociionale konsiderohen të kryera nga Kontrolluesi, i cili njëkohësisht ngarkohet me të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Për rrjedhojë, është përgjegjësia e Kontrolluesit *“Express Print”* të sigurohet që të zbatohen kriteret e përpunimit të të dhënave personale, përpara dërgimit të mesazheve promociionale. Gjatë hetimit administrativ, Kontrolluesi nuk dokumentoi pëlqimin e subjekteve të të dhënave, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Në vijim të email-it, Kontrolluesi pretendon se:

- *Vlerësoj paraprakisht të sqaroj se organi shtetëror, që Ju përfaqësoni, nuk ka tagra dhe kompetenca për të shqyrtuar një marrëdhënie tregtare/civile midis dy subjekteve private, sikundër janë shoqëria që përfaqësoj dhe shoqëria tregtare Vodafone sh.a. Nëse palët kontraktuese kanë pretendime në lidhje me ekzekutimin e kontratës së nënshkruar midis tyre, ato mund ti drejtohen organeve gjyqësore, të cilat janë të vetmet organe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo për pretendimet në lidhje me mospërbushjen e detyrimeve kontraktore.*
- Përfundimisht për sa parashtrova më sipër, nëse kam ndonjë përgjegjësi e kam kundërshtim subjektit Vodafone sh.a. dhe kurrësesi të kem cenuar ndonjë dispozitë ligjore.*

Sa i takon këtij pretendimi, ju bëjmë me dije se, Zyra e Komisionerit është institucion i pavarur i cili mbikëqyr mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit nuk ka shqyrtuar vlefshmërinë e kontratës midis palëve, por në kuadër të kompetencave të saj institucionale për të mbikëqyruar dhe monitoruar respektimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka analizuar dokumentacionin e administruar përgjatë hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e qartë të rolit dhe përgjegjësisë së “Express Print”. Konkretisht, kontrata e lidhur midis Vodafone sh.a. dhe “Express Print” evidenton që është ky i fundit, si posedues i kartave SIM/numrave të celularit, ai që mbart përgjegjësinë e përpunimit të të dhënave personale, në cilësinë e Kontrolluesit.

Termet e përgjithshme të kontratës me pajtimtarët që ka aplikuar Vodafone sh.a. rikonfirmojnë përgjegjësinë e pajtimtarit për të gjitha komunikimet e kryera nëpërmjet kartës/kartave SIM.

Gjithashtu, në email, Kontrolluesi pretendon se:

- *“Në lidhje me pretendimin se subjekti që përfaqësoj, ka shkelur dispozitat e nenit 6 dhe 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, më lejoni t’iu sqaroj për sa më poshtë vijon: Shoqëria “Express Print” shpk., nuk ka trajtuar dhe nuk ka përpunuar asnjë të dhënë personale të asnjë shtetasi në kuadër të fushatës zgjedhore. Të dhënat personale janë trajtuar dhe janë përpunuar ekskluzivisht nga ana e subjektit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Këlliçi. Shoqëria “Express Print” shpk., nuk ka administruar asnjë të dhënë, nuk i ka arkivuar ato, nuk ka pasur fare lidhje me proceset e përpunimit të këtyre të dhënave personale, duke mos pasur kurrësi disponibilitetin apo vendimmarrje lidhur me trajtimin e tyre. ... Në lidhje me parashikimet e nenit 21 të ligjit të cituar më sipër, vlerësojmë se subjekti që përfaqësoj nuk është Kontrollues, në kuptim të përcaktimeve të ligjit... Në cilin moment, subjekti që përfaqësoj ka përcaktuar qëllimet apo mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, kur ky subjekt nuk ka pasur në asnjë moment disponibilitetin e tyre apo ndonjë qëllim për përpunimin e tyre. Jo vetëm që shoqëria “Express Print” shpk. nuk është në cilësinë e Kontrolluesit por nuk është as Përpunues, në kuptim të ligjit, për shkak se sikundër parashtrua më sipër, nuk ka pasur disponibilitetin e këtyre të dhënave.”*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim i subjektit zërthehet në mënyrë të detajuar në faqen 4 të këtij akti, ku specifikohet qartazi pse subjekti “Express Print shpk” gëzon atributet e Kontrolluesit, dhe si i tillë ka përgjegjësinë e plotë të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndër të tjera, një nga detyrimet bazë të çdo Kontrolluesi është edhe ai i sanksionuar në pikën 1, të nenit 21 të Ligjit i cili parashikon se, “Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.

Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”. Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për “Njoftim”, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore përpara përpunimit të të dhënave personale. Njëkohësisht ky parashikim i mundëson subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i njeh Ligji.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a” dhe “d” të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 21, 29, 30, 39 (pika 1, gjerat “a” dhe “d”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të këtë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të “Njoftojë” Zyrën e Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;

5. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 4 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

6. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

7. Gjyba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;

8. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 30.08.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi